



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

RREGULLA PËR MASAT ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Prishtinë,2017



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7, Nenin 26, Nenin 57 dhe Nenin 58 paragrafin 2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), në seancën e mbajtur me datë ... 2017 miratoi:

RREGULLËN PËR MASAT ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulle është mbikëqyrja e aktiviteteve të licencuara në sektorin e energjisë si dhe shqiptimi i masave administrative dhe gjobave, në rast të shkeljes së tyre.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Zyra e Rregullatorit për Energji ushtron mbikëqyrje për:
 - 1.1. pajtueshmërinë me kushtet e licencës;
 - 1.2. zbatimin e çmimeve dhe tarifave të aprovuara; dhe
 - 1.3. zbatimin e Rregullave, akteve nënligjore, vendimeve dhe udhëzimeve të nxjerra nga Rregullatorit
2. Gjatë kryerjes së aktiviteteve Rregullatorit mund të:
 - 2.1. kryejë inspektime përmes personave të autorizuar nga ajo;
 - 2.2. njoftojë, autoritetet publike ose organe të pavarura, mbi masat që duhet të ndërmerren brenda kompetencave të tyre;
 - 2.3. suspendon, modifikon apo revokon licencën, si dhe,
 - 2.4. vendosë masa administrative dhe gjoba të detyrueshme.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1 **“ZRRE”** Zyra e Rregullatorit për Energji;
 - 1.2 **“Informatë konfidenciale”** të dhëna, dokumente apo informacione të tjera, komerciale apo teknike, që kanë të bëjnë me dizajnin, rehabilitimin, sigurinë, veprimin, mirëmbajtjen dhe financimin e veprimeve energjetike apo aktivitete që nuk janë më në domenin publik dhe

që shpallja e tyre mund t'i vë në rrezik interesat komerciale të aplikuesve apo të të licencuarve;

1.3 **“Person”** person fizik ose juridik.

1.4 Zyra e Rregullatorit për Energji - (në tekstin e mëtejshëm: Rregullatori) – është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

2. Shprehjet e përdorura në këtë Rregull, kanë kuptimin e shprehjeve të përdorura në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për gazin natyror, Ligjin për Ngrohjen Qendrore, Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

KREU II MBIKËQYRJA

Neni 4

Mbikëqyrja nga Rregullatori

1. Bazuar në Nenin 15 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Rregullatori mbikëqyrë, vëzhgon dhe siguron pajtueshmërinë me licencat. Po ashtu sipas Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, Rregullatori mbikëqyrë aktivitetet e ushtruara nga të licencuarit për pajtueshmërinë me kushtet e licencave.
2. Personi i autorizuar nga Bordi i Rregullatorit, do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e aktiviteteve të licencuara në sektorin e energjisë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Rregullat e nxjerra nga Rregullatorit dhe ligjet në fuqi.
3. Personi i autorizuar do të përgatisë raport lidhur me mbikëqyrjen e bërë në ndërmarrjen e licencuar, i cili raport do t'i paraqitet Bordit të Rregullatorit.
4. Personi i autorizuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, sipas nevojës, do të bashkëpunojë me të gjitha autoritetet relevante në Kosovë.
5. Bazuar në Nenin 54 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, gjatë përmbushjes së mbikëqyrjes, Rregullatori mund të kryejë inspektime nëpërmjet personave të autorizuar nga ajo; mund të kryejë inspektime të pajisjeve në objekte të të Licencuarit (vizita periodike me paralajmërim apo pa paralajmërim); njoftojë autoritetet publike apo organet e pavarura mbi masat që duhet të ndërmerren brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre; suspendon, modifikon apo revokon licencën kur kjo është e nevojshme për të trajtuar shkeljen e kushteve të licencës; imponon masa të detyrueshme administrative dhe gjoha administrative sipas kësaj rregulle dhe ligjeve tjera në fuqi.

Neni 5

Detyrimet e të Licencuarit

1. I Licencuari do të marrë të gjitha masat e duhura që të ndihmojë Rregullatorin në aktivitetet e tyre mbikëqyrëse, dhe do të sigurojë çdo të dhënë dhe informacion të kërkuar brenda periudhës së përcaktuar në licencë, Doracakun e Raportimit, në ndonjë Urdhëresë apo Udhëzim për të licencuarin, të lëshuar nga Rregullatori.



2. I Licencuari duhet të informojë Rregullatorin sa më shpejtë që të jetë e mundur, për çdo pengesë ligjore, teknike ose administrative që mund të parandalojë përmbushjen e kushteve të licencës, përpara se të ndodhë mbikëqyrja ose inspektimi që do të kryhet nga ana e personit të autorizuar.
3. I Licencuari duhet të respektojë çdo afat dhe udhëzim të dhënë nga Rregullatori në lidhje me pajtueshmërinë me kushtet e licencës.

KREU III

MASAT ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Neni 6

Parimet për vendosjen e masave administrative dhe gjobave

1. Nëse i Licencuari kryen aktivitete të cilat janë të dënueshme sipas Nenit 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Rregullatori do të vlerësojë dhe do të vendosë mbi vënien e gjobave në një mënyrë të shpejtë dhe të drejtë, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle.
2. I Licencuari që kryen disa shkelje, mund të ndëshkohet për secilën shkelje.
3. Forma dhe lartësia e gjobës do të bazohet në llojin dhe peshën e shkeljes.

Neni 7

Faktorët lehtësues

1. Faktorët vijues që konsiderohen si lehtësues janë:
 - 1.1. i Licencuari është përpjekur të parandalojë ose të pakësojë dëmin e shkaktuar nga shkelja, ose ka paguar kompensim për dëmin e shkaktuar;
 - 1.2. shkalla e dëmit që i është bërë shoqërisë;
 - 1.3. sjellja paraprake e personit;
 - 1.4. gjendja financiare e personit; si dhe
 - 1.5. shkelja ka qenë aksidentale.
2. Nëse shkelja përfshin një faktor lehtësues siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij Neni, gjoba do të zbritet deri në 50% të vlerës së përcaktuar sipas Nenit 11 të kësaj rregulle. Në rast se ka dy ose më shumë faktorë lehtësues, do të aplikohet zbritja e dy të tretave (2/3) të gjobës ose mund të lirohet nga gjobitja. Rregullatori do të arsyetojë çdo vendim që merr.
3. I Licencuari do të dokumentojë te Rregullatori përpjekjet e tij për veprimet e tij parandaluese.



Neni 8

Njoftimi për mos-pajtueshmëri

1. Nëse personi i autorizuar nga Rregullatori përcakton se i Licencuari nuk vepron në pajtim me ligjet në fuqi, dhe kushtet e licencës, ose me ndonjë vendim apo akt tjetër të nxjerrë nga Rregullatori, ai do t'i japë të Licencuarit një Njoftim me shkrim për mos-pajtueshmërinë.
2. Ky Njoftim për mos-pajtueshmërinë do të:
 - 2.1. përcaktoj natyrën e dështimit;
 - 2.2. i japë të Licencuarit një periudhë kohore të arsyeshme për të kryer disa veprime ose për të ndërprerë veprimet që shkaktuan nxjerrjen e njoftimit. Kjo periudhë nuk do të jetë më e shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike dhe jo më e gjatë se katërdhjetepesë (45) ditë kalendarike, përveç nëse dështimi kërcënon ose mund të krijojë situata me të vërtetë të rrezikshme;
 - 2.3. identifikojë ato masa që duhet të marrë i Licencuari për të korrigjuar shkeljet që mund të përfshijnë pagimin e një kompensimi të arsyeshëm nga ana e të Licencuarit ndaj palës së prekur, ose edhe masa të tjera që mund të ndërmerren dhe që nuk kërkojnë përpjekje të mëdha brenda një periudhe më të shkurtër kohore; si dhe
 - 2.4. përmbajë udhëzime mbi të drejtën e të Licencuarit për t'u përgjigjur me shkrim.
3. I Licencuari do të përgjigjet ndaj Njoftimit për mos-pajtueshmëri brenda katërmëdhjetë (14) ditësh kalendarike pas marrjes së njoftimit.

Neni 9

Masat Administrative

1. Nëse i Licencuari dështon në përmbushjen e kërkesave pas afatit të paraqitur në Nenin 8 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të kësaj Rregulle, Rregullatori mund të vendosë masat administrative ose gjobat të parapara në këtë Rregull, përfshirë përfundimin ose tërheqjen e licencës.
2. Nëse Rregullatori përcakton se i Licencuari ka shkelur kushtet dhe obligimet e licencës, mund të:
 - 2.1. kërkojë që i Licencuari përkohësisht të ndërpresë kryerjen e aktiviteteve që shkaktojnë shkeljen e licencës;
 - 2.2. deklarojë të pavlefshëm çdo akt ose vendim që përbënë shkeljen, ta anulojë dhe ta shfuqizojë atë; dhe
 - 2.3. kërkojë që i Licencuari të kryejë të gjithë veprimet e arsyeshme që konsiderohen si të nevojshme për të siguruar eliminimin ose ndryshimin e efekteve negative, dhe se kjo shkelje nuk do të përsëritet më.

Neni 10

Shkeljet ndaj Palës së Tretë

1. Nëse I Licencuari ka bërë shkelje të kushteve të Licencës dhe ajo shkelje shkakton apo kanos të shkaktoj dëm material, përfshirë humbjen e përfitimit, apo ndonjë dëm tjetër palës së tretë, pala e dëmtuar ka të drejtë të bëjë ankesë në Rregullator, në përputhje me Rregullën për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.
2. E drejta e palës së dëmtuar nuk përjashton përgjegjësitë civile apo penale të kryesit të shkeljes të përcaktuar me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

Neni 11

Gjobat

1. Bazuar në Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë gjoba do të vendosen për shkeljet si në vijim:
 - 1.1. punëson persona që nuk kanë kualifikimet e kërkuara sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.2. nuk jep informata të kërkuara sipas nenit 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.3. zbulon informata konfidenciale në mënyrë të papranueshme;
 - 1.4. nuk jep ndihmën e kërkuar sipas Nenit 13 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.5. mban llogaritë në mënyrë që nuk është në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës;
 - 1.6. kyçet në rrjet pa respektuar kushtet përkatëse;
 - 1.7. refuzon të lejojë Rregullatorin të ketë qasje në llogaritë e të licencuarit;
 - 1.8. nuk arrin të përmbush detyrat e tij/saj sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.9. ndërton stabilimente në kundërshtim me dispozitat e Kapitullit VIII të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.10. nuk vepron në pajtim me masat e imponuara sipas nenit 16 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë për të parandaluar keqpërdorimin e pozitës dominuese;
 - 1.11. merret me aktivitete energjetike, për të cilat nevojitet licenca pa pasur licencë;
 - 1.12. nuk arrin të përmbushë kushtet apo afatet e licencës;
 - 1.13. vendos tarifa që janë subjekt rregullimi, pa miratimin e Rregullatorit;
 - 1.14. refuzon të lidh kontrata për furnizim me energji, për të siguruar qasje në sisteme pa arsyetim të qëndrueshëm;
 - 1.15. kryen veprime që janë në kundërshtim me rregullat teknike ose komerciale, standardet ose kodet teknike;
 - 1.16. kryen veprime në kundërshtim me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë ose në kundërshtim me licencën e tij;



- 1.17. vepron në kundërshtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjisë Elektrike, Ligjin për Energjinë, rregullat e përcaktuara në pajtim me këto ligje, apo standardet ose kodet përkatëse teknike.
2. Për Shkeljet e përcaktuara nga paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 deri në 1.7 të këtij Neni do të shqiptohet gjoba prej pesëmijë (5,000.⁰⁰ €) euro deri në pesëdhjetëmijë (50,000.⁰⁰ €) euro.
 3. Për Shkeljet e përcaktuara nga paragrafi 1 nën-paragrafi 1.8 deri në 1.17 të këtij Neni, të licencuarit do t'i shqiptohet gjoba mbi pesëdhjetëmijë (50,000.⁰⁰ €) euro e deri në shumën 10% të të ardhurave që ndërmarrja ka akumuluar gjatë vitit paraprak fiskal.
 4. Gjoba prej minimumi një e treta (1/3) e pagës neto të pagës së fundit mujore dhe maksimumi deri trefishin (x 3) e pagës neto të pagës së fundit mujore do t'i shqiptohet personit përgjegjës të ndërmarrjes së i cili bënë shkeljet sipas paragrafit 1 të këtij Neni.
 5. Niveli i gjobës që do të shqiptohet sipas paragrafit 2, 3 dhe 4 të këtij Neni do të varet nga faktorët si në vijim:
 - 5.1. vlera materiale e dëmit të shkaktuar;
 - 5.2. numri i konsumatorëve të prekur;
 - 5.3. përfitimet financiare nga ngarkimet e konsumatorëve dhe veprimet e paligjshme të ndërmarrja; dhe
 - 5.4. ndikimi i shkeljes në funksionimin e tregut të energjisë;
 6. Në rast të shkeljes së përsëritur, gjoba e vendosur mund të jetë tri (3) herë më e madhe se shuma e cekur në paragrafin 2, 3, dhe 4 të këtij Neni.
 7. Vendimi i Rregullatorit për shqiptimin e ndonjë gjobe sipas kësaj Rregulle, në asnjë mënyrë nuk kufizon të drejtën e saj për të pezulluar/anuluar licencën.
 8. Vendimi për shqiptimin e gjobës apo masës administrative nxjerrë nga Rregullatori mund të kontestohet në Gjykatën kompetente.
 9. Ankesa kundër vendimit të Rregullatorit për gjobë apo masë administrative nuk do ta shtyjë ekzekutimin e vendimit.
 10. Nëse gjoba e shqiptuar nga Rregullatori nuk paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor, Rregullatori do të filloj procedurën gjyqësore për pagesën e gjobës si borxh civil.
 11. Gjoba e shqiptuar ndaj të licencuarit nuk eliminon përgjegjësinë e tij penale sipas Kodit Penal të Kosovës.
 12. Të gjitha gjobat e mbledhura sipas këtij neni do të paguhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

KREU IV NDËRPRERJA APO PEZULLIMI I LICENCËS



Neni 12

Ndërprerja apo pezullimi i Licencës

1. Rregullatori do të marrë të gjithë hapat e nevojshëm, përfshirë vendosjen e gjobave, nëse këto të fundit ose masat tjera mund të eliminojnë arsyet për përfundimin ose tërheqjen e licencës dhe parandalojnë ndërmarrjen e këtyre masave. Ndërprerja apo pezullimi duhet përdorur si hapi i fundit, nëse të gjitha masat e tjera të përcaktuara në këtë Rregull nuk kanë arritur të japin efektin e dëshiruar.
2. Duke iu referuar Njoftimit për mos pajtueshmëri të përcaktuar në Nenin 8 të kësaj rregulle, kjo Rregull përcakton kriteret minimale, ndërsa Rregullatori mund të nxjerrë njoftim shtesë për të shtyrë periudhën e kohës së përcaktuar në Nenin 8 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 të kësaj Rregulle, që i Licencuari të veprojë në pajtueshmëri me kushtet e licencës.
3. Nëse dështimi i të Licencuarit vazhdon për më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarike nga nxjerrja e Njoftimit për mos pajtueshmëri ose njoftimit shtesë sipas paragrafit 2 të këtij Neni, dhe pas propozimit nga personi i autorizuar, Rregullatori do të njoftojë të Licencuarin në lidhje me ndërprerjen apo pezullimin e licencës. Ky njoftim do të përmbajë datën kur licenca do të ndërpritet apo pezullohet.
4. Rregullatori mund të ndërpresë apo pezullojë licencën në përputhje me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
5. Ndërprerja apo pezullimi i licencës do të hyjë në fuqi pas nxjerrjes së Vendimit me shkrim nga Bordi i Rregullatorit.
6. Në rast se Rregullatori ka nxjerrë një Vendim që i referohet paragrafit 5 të këtij Neni, atëherë ajo do të emërojë një të licencuar tjetër për të mbrojtur sigurinë e furnizimit dhe për të vënë në funksion asetet që i përkasin të licencuarit të cilit i është tërhequr licenca.
7. Vendimi për ndërprerje apo pezullim të licencës nxjerrë nga Rregullatori mund të kontestohet në Gjykatën kompetente.

KREU V

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Gjuha zyrtare

Kjo Rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 14

Ndryshimi

1. Rregullatori mban të drejtën që të ndryshoj ose modifikoj çdo dispozitë të kësaj rregulle.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj Rregulle, do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 15
Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 16
Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat, nxjerr në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185) dhe të miratuar nga Bordi i Rregullatorit me datë 17.06.2011.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Rregulla hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Rregullatorit, dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.

Bordi i Rregullatorit

Krenar Bujupi, U.D Kryesues

Arsim Janova, Anëtar

Besim Sejfiqaj, Anëtar